

# **Golden Eagle Sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më  
31 dhjetor 2012  
(Shoqëruar me raportin e auditorit të pavarur)**



**KPMG Albania Sh.p.k**  
"Dëshmorët e Kombit" Blvd  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524  
+355(4)2274 534  
Telefax +355(4)2235 534  
E-mail al-office@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

## Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të  
Golden Eagle Sh.p.k

Tiranë, 29 mars 2013

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Golden Eagle Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga bilanci kontabel në 31 dhjetor 2012, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



### *Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2012, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

*KPMG Albania Shpk*

KPMG Albania Sh.p.k.  
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.  
Twin Towers Buildings,  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

**Golden Eagle Sh.p.k.**  
**Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2012**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

<b>AKTIVET</b>	<b>Shënime</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
<b>AKTIVET AFATSHKURTRA</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	4	521,423	404,942
Inventarë	5	12,480	24,242
Kërkesa të arkëtueshme	6	62,706	51,317
Tatim fitim i parapaguar		7,217	9,379
Shpenzime të parapaguara		6,674	4,329
		<b>610,500</b>	<b>494,209</b>
<b>AKTIVET AFATGJATA</b>			
Aktive afatgjata materiale	7	539,659	555,939
Aktive afatgjata jomateriale	8	3,054	2,495
		542,713	558,434
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,153,213</b>	<b>1,052,643</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>DETYRIMET AFATSHKURTRA:</b>			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	9	40,304	20,350
Të pagueshme të tjera	10	52,440	78,447
		<b>92,744</b>	<b>98,797</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar	11	532,936	532,936
Rezerva ligjore	11	20,286	20,286
Rezerva të tjera		21,046	21,046
Fitimet e pashpërndara		486,201	379,578
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,060,469</b>	<b>953,846</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,153,213</b>	<b>1,052,643</b>

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Golden Eagle Sh.p.k.****Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	<b>Shënime</b>	<b>2012</b>	<b>2011</b>
Të ardhurat	12	526,947	548,697
Të ardhura të tjera	16	98,858	102,648
Të hyra tjera	10	47,541	-
Materialet e konsumuara	13	(101,476)	(65,739)
Shërbime	14	(179,304)	(172,218)
Shpenzimet e personelit	15	(108,048)	(90,908)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	7,8	(40,470)	(44,000)
Shpenzime të tjera	16	(132,598)	(134,975)
<b>Fitim nga veprimtaria kryesore</b>		<b>111,450</b>	<b>143,505</b>
<b>Shpenzime financiare neto</b>			
Shpenzime financiare	17	(6,161)	(7,163)
Të ardhura financiare	17	9,758	4,158
		<b>3,597</b>	<b>(3,005)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>115,047</b>	<b>140,500</b>
<b>Shpenzimet e tatimit mbi fitimin</b>	18	<b>(8,424)</b>	<b>(15,641)</b>
<b>Fitimi neto për periudhën</b>		<b>106,623</b>	<b>124,859</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Golden Eagle Sh.p.k.****Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	<i><u>Kapitali aksioner</u></i>	<i><u>Rezerva ligjore</u></i>	<i><u>Rezerva të tjera</u></i>	<i><u>Fitimi i pashperndarë</u></i>	<i><u>Totali</u></i>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>532,936</b>	<b>20,286</b>	<b>21,046</b>	<b>254,719</b>	<b>828,987</b>
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	124,859	<b>124,859</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2011</b>	<b>532,936</b>	<b>20,286</b>	<b>21,046</b>	<b>379,578</b>	<b>953,846</b>
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	106,623	<b>106,623</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>532,936</b>	<b>20,286</b>	<b>21,046</b>	<b>486,201</b>	<b>1,060,469</b>

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.


**Golden Eagle Sh.p.k.****Pasqyra e fluksit monetar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	Shënime	2012	2011
<b>Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Fitimi neto për periudhën		106,623	124,859
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7,8	40,470	44,000
Nxjerrje jashtë përdorimit i aktiveve afatgjata materiale	7	349	15,608
Fondi për zhvlerësimin	6	4,845	(1,691)
Shpenzime për interesat dhe komisionet		6,161	7,163
Të ardhura nga interesat		(7,010)	(4,789)
<i>Ndryshime në kapitalin punues:</i>			
Ndryshim në tepricën e inventarit		11,762	2,290
Ndryshim në tepricën e llogarive të arkëtueshme		(16,233)	(18,662)
Ndryshim në tepricën e llogarive të pagueshme nga palët e lidhura		-	-
Ndryshim në tepricën e shpenzimeve të parapaguara		(2,343)	(2,740)
Ndryshim e në tepricën e tatim fitimit të parapaguar		2,161	(9,379)
Ndryshim në tepricën e llogarive/kerkesa të pagueshme		19,954	2,641
Ndryshim në tepricën e llogarive të tjera të pagueshme		(26,009)	(878)
<b>Flukse monetare të gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>140,730</b>	<b>158,422</b>
Interes i arkëtuar		7,010	4,790
Interesa dhe komisione të paguara		(6,161)	(7,163)
<b>Flukse monetare neto të gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>141,579</b>	<b>156,049</b>
<b>Flukse monetare nga aktivitete investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	7	(25,098)	(4,670)
<b>Mjete monetare neto të përdorura në aktivitete investuese</b>		<b>(25,098)</b>	<b>(4,670)</b>
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të saj		116,481	151,379
Mjete monetare dhe ekuivalentë në 1 Janar	4	404,942	253,563
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë në 31 Dhjetor</b>	4	<b>521,423</b>	<b>404,942</b>

Pasqyra e fluksëve monetare duhet të lexohet së bashku me shënime shpjeguese në faqet 5 – 18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Drejtuesit e Golden Eagle Sh.p.k më 29 Mars 2013 dhe janë firmosur nga:

  
Joashim Kipper  
Administrator

  
Herman Stingeder  
Drejtor i Përgjithshëm

Rogner Hotel Tirana  
Golden Eagle sh.p.k  
Blvd. Dëshmoret e Kombit, AL – 1000 Tirana  
Tel.: +355 4 2235035  
info.tirana@rogner.com

## **Golden Eagle Sh.p.k.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

#### **1. Njësia raportuese**

Golden Eagle Sh.p.k. (“Shoqëria”) është themeluar më 5 Qershor 1993 në Tiranë, Shqipëri, me qëllim ndërtimin dhe menaxhimin e Hotel Rogner Europapark (Hoteli). Forma ligjore e saj është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, dhe është e regjistruar në Rregjistrin Tregetar me vendimin nr. 3709/1, datë 5 Qershor 1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Objekti kryesor i biznesit është menaxhimi i aktivitetit hotelier, i nënkontraktuar nga Shoqëria Austriake Rogner International Hotels and Resorts GmbH, e profesionalizuar në menaxhim hotelesh. Klientët kryesorë janë biznesmenë të huaj, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare, si edhe të misioneve të huaja qeveritare.

Adresa e selisë kryesore të biznesit është Tiranë, Shqipëri. Shoqëria Mëmë është Rogner GmbH Austri.

Më 31 Dhjetor 2012, Shoqëria ka pasur 118 punonjës (2011:121) dhe aksionerë ishin:

	<i>Ne %</i>	
	<i>2012</i>	<i>2011</i>
Rogner GmbH	75.81	75.81
Rogner International Hotels and Resorts GmbH	24.19	24.19
<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

#### **2. Parimet e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare**

##### **(a) Deklarata e parimeve kontabel**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 “Tatim Fitimi”, paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos raportojë në pasqyrat e saj financiare për tatimin e shtyrë dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012.

##### **(b) Parimet e Përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

##### **(c) Monedha funksionale dhe e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë, dhe janë paraqitur në mije leke të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt.

##### **(d) Vlerësimet dhe gjykimet**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin, vlerësimin dhe çmuarjet e tyre, gjë e cila ndikon në politikën kontabël që zbatohen dhe në vlerat e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultati faktik mund të ndryshojë prej këtyre vlerësimeve. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto rishikime kryhet si dhe në periudhat e ardhshme që mund të preken. Në mënyrë të veçantë, informacioni që ka të bëjë me vlerësimet e pasigurta të aspekteve më domethënëse dhe gjykimet kritike përsa i përket aplikimit të politikave kontabël që kanë efektin më kryesor në shumën e njohura në pasqyrat financiare, paraqitet në shënimet respektive të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare korrente.



## **Golden Eagle Sh.p.k.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

---

#### **3. Politikat kontabël**

##### **(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet financiare dhe detyrimet të cilat janë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që janë mature me koston historike konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### **(b) Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen në hyrje me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentet e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve që përshkruhen më poshtë. Me pas njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë në flukset monetare që vijnë prej aktivitetit financiar përfundojnë ose nëse Shoqëria ia transferon aktivin financiar një palë tjetër pa ruajtur kontrollin apo në thelb risqet dhe përfitimet prej aktivitetit. Blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e tregimit, domethënë në datën në të cilën Shoqëria merr përsipër ta blejë apo shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë, e specifikuar kjo në kontratë, përfundojnë, pushojnë ose anulohen.

##### *Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë balancat e parasë në dorë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat bankare afatshkurtra. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozitat e pakushtëzuara me afat maturimi deri në tre muaj, ose më pak, nga data e krijimit. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e gjendjes financiare.

##### *Kërkesa të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme në hyrje njihen me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjera financiare jo-derivativë janë matur me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3.k.

##### *Kapitali aksioner*

Kapitali aksioner i Shoqërisë matet me vlerë nominale.

## **Golden Eagle Sh.p.k.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

---

#### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

##### **(c) Aktivet afatgjata materiale**

###### *(i) Njohja dhe vlersimi*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale vleresohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka).

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve, koston e punës (nëse është përdorur), dhe çdo kosto tjetër që ndikon drejtpërdrejt për ta sjellje aktivin në kushte pune për qëllimet e parashikuara të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit dhe heqjes së objektit, si edhe të rikthimit në gjendjen fillestare të terrenit ku ata janë vendosur. Shpenzimet kapitale të aktiveve që bëhen përgjatë kohës së ndërtimit të tij, ngarkohen nën "Aktive fikse të parapaguara" dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit në momentin kur ndërtimi përfundon, moment ky në të cilin fillon të aplikohet amortizimi me normën përkatëse të kategorisë së ciles i përket aktivi.

Kur pjesë të ndryshme të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatesi të ndryshme përdorimi, atëherë ato kontabilizohen si aktive afatgjata materiale më vete (komponentë kryesorë).

###### *(ii) Kostot vijuese*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një aktivi afatgjatë material njihet si pjese e vlerës së mbetur të aktivitetit vetëm nëse pritet që në të ardhmen të rrjedhin përfitime ekonomike të përfshira në të dhe të kjo pjesë dhe nëse kostoja e saj mund të matet në mënyrë të besueshme.

Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si humbje apo fitime në periudhën që ato kryhen.

###### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe llogaritet me metodën e vlerës së mbetur. Aktivet me qera amortizohen gjatë më të vogël midis kohëzgjatjes së qerasë dhe jetëgjatësisë së tyre të përdorimit. Toka dhe aktivet fikse të parapaguara nuk amortizohen.

Normat e amortizimit për periudhën korrente dhe ato krahasuese janë si më poshtë:

- |                            |                 |
|----------------------------|-----------------|
| • Ndërtesa                 | 5%              |
| • Pajisje zyre dhe dhomash | 20% deri në 25% |
| • Automjete                | 20%             |

Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura të aktiveve afatgjata materiale, kur janë të rëndësishme, rivlerësohen në datën e raportimit.

##### **(d) Aktivet jomateriale**

Aktivitetet jomateriale të blera prej Shoqërisë njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka). Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohen vetëm nëse rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të mishëruara në aktivin specifik të cilit i referohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në humbje dhe fitime në periudhën kur ndodhin. Amortizimi njihet në humbje ose fitime mbi bazën e vlerës së mbetur me një normë 25% në vit, duke filluar që prej datës në të cilën aktivitetet kanë qënë të gatshme për përdorim.

## **Golden Eagle Sh.p.k.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

---

#### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

##### **(e) Aktivet me qera**

Qeratë, përmes të cilave Shoqëria merr përsipër kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet pronësore klasifikohen si qera financiare. Në momentin e njohjes fillestare (ne hyrje) aktivi vlerësohet me më të voglën midis vlerës së drejtë të tij dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qerasë.

Pas njohjes fillestare, aktivi kontabilizohet në përputhje me politikat kontabël të aplikueshme për atë aktiv. Qeratë e tjera njihen si qera operative dhe në këtë rast aktivet me qera nuk njihen në pasqyrën e gjendjes financiare të Shoqërisë.

##### **(f) Inventarët**

Inventarët maten me më të voglën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është sa çmimi i vlerësuar i shitjes në një periudhë normale biznesi, minus kostot e vlerësuara të kompletimit të tij dhe shitjes.

Kostoja përfshin shpenzimet e blerjes së inventarit dhe shpenzimet e sjelljes së tij në vendin the kushtet ekzistuese. Kostoja e inventarëve të konsumuara bazohet në formulën hyrje e parë, dalje e parë.

##### **(g) Zhvlerësimi**

###### **(i) Aktivet financiare**

Një aktiv financiar do të konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka prova objektive që dëshmojnë se një apo më shumë ngjarje kanë pasur efekt negativ në flukset e ardhshme të vlerësuara të parasë të atij aktivi.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të vlerësuar të flukseve të ardhshme të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit. Humbja nga zhvlerësimi e një aktivi financiar të gatshëm për shitje llogaritet duke iu referuar vlerës së tij të drejtë korrente.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen individualisht për të përkrahur zhvlerësimin. Pjesa tjetër e aktiveve financiare, si për shembull llogaritë e arkëtueshme nga klientë të rregullt, vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe të cilat kanë të njëjtat karakteristika risku. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të vlerësuara me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

###### **(ii) Aktivet Jo-financiare**

Vlera kontabël neto e aktiveve jo financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka apo jo ndonjë të dhënë për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë të dhëna të tilla atëherë bëhet vlerësimi i vlerës së rikuperueshme të aktivitetit.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël neto e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **Golden Eagle Sh.p.k.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

---

#### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

##### **(h) Shpenzimet per Personelin**

*Kontributet per Sigurimet Shoqerore*

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, sipas legjislacionit në fuqi, Shoqëria kryen pagesa për të kontribuar në pensionet e detyrueshme, si për llogari të saj ashtu edhe për llogari të punonjësve të saj. Kostot që i takojnë Shoqërisë paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën në të cilën ato ndodhin.

*Lejet e zakonshme të paguara*

Shoqëria njih si detyrim shumat e plota të kostove të vlerësuara lidhur me lejet vjetore që pritet ti paguhen punonjësve përkundrejt shërbimit të tyre për periudhën e plote raportuese.

##### **(i) Provigjonet**

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim të tanishëm ligjor apo konstruktiv, detyrim i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe që për shlyerjen e tij mund të jete e nevojshme dalja e burimeve ekonomike. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritshme të parasë përmes një norme para tatimit që reflekton vlerësimin korrent të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të lidhura me detyrimin në fjalë.

##### **(j) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga dhomat, ushqimi dhe pijet, banketet dhe shërbimet e tjera njihen ne baze të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara ndërkohë që shërbimet kryhen. Në të ardhura nuk njihen detyrime të mundshme qeraje.

Të ardhurat e qerave prej qeramarrësve njihen mbi baza lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

Nëse rezultati i një transaksioni që lidhet me ofrimin e një shërbimi mund të matet në mënyrë të besueshme, e ardhura e lidhur me këtë transaksion do të njihet ne masen që i korrespondon fazes të kompletimit të transaksionit në datën e bilancit.

##### **(k) Shpenzimet dhe të ardhurat financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat prej fondeve të investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. E ardhura nga interesat njihet mbi baza rritëse.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave prej huave dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Të gjitha kostot e huamarrjes do të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, nëse ka.

##### **(l) Shpenzimi për tatim fitimin**

Shpenzimi për tatim fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. tatimi i periudhës përbën tatimin e pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

**Golden Eagle Sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***4. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga:

	<b>31 Dhjetor 2012</b>	<b>31 Dhjetor 2011</b>
<b><i>Mjete Monetare në dorë</i></b>		
Arka (LEK)	1,441	11,240
Arka (EUR)	56	25
	<b>11,265</b>	<b>5,859</b>
<b><i>Mjete Monetare në banka</i></b>		
Raiffeisen Bank (Lek)	273,831	172,199
Raiffeisen Bank (EUR)	176,777	154,715
Raiffeisen Bank (USD)	2,341	389
RLB NOË Ëiene AG	13,278	45,262
Intesa Sanpaolo Bank (LEK)	3,349	8,602
Intesa Sanpaolo Bank (EUR)	38,736	1,954
Alpha Bank (EUR)	-	10,556
Alpha Bank (LEK)	11,614	-
	<b>519,926</b>	<b>393,677</b>
	<b>521,423</b>	<b>404,942</b>

**5. Inventarët**

Inventarët përbëhen nga:

	<b>31 Dhjetor 2012</b>	<b>31 Dhjetor 2011</b>
Pajisjet e dhomave	5,048	16,723
Ushqim	2,317	2,439
Pajisjet për pastrim	753	624
Pije	2,738	2,514
Materiale të tjera	1,624	1,942
	<b>12,480</b>	<b>24,242</b>

**6. Kërkesa të arkëtueshme**

Te arkëtueshmet përbëhen nga:

	<b>31 Dhjetor 2012</b>	<b>31 Dhjetor 2011</b>
Llogari të arkëtueshme	36,362	33,744
Tatimi i mbajtur në burim i arkëtueshëm	10,024	10,024
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	15,795	7,121
Karta krediti	525	428
	<b>62,706</b>	<b>51,317</b>

***Llogari të arkëtueshme***

	<b>31 Dhjetor 2012</b>	<b>31 Dhjetor 2011</b>
Llogari të arkëtueshme	43,189	35,726
Minus: Fondi për humbjet nga zhvlerësimet	(6,827)	(1,982)
	<b>36,362</b>	<b>33,744</b>

**Golden Eagle Sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***7. Aktive afatgjata materiale**

Aktivet afatgjata materiale përbëhen nga:

	<i>Ndërtesa</i>	<i>Pajisje zyre dhe dhomash</i>	<i>Automjete</i>	<i>Aktive fikse të parapaguara</i>	<i>Totali</i>
<b><i>Kosto</i></b>					
Më 1 Janar 2011	1,613,530	347,330	810	15,608	1,977,278
Shtesa	-	4,321	-	349	4,670
Nxjerrje jashte përdorimit	-	-	-	(15,608)	(15,608)
<b>Më 31 Dhjetor 2011</b>	<b>1,613,530</b>	<b>351,651</b>	<b>810</b>	<b>349</b>	<b>1,966,340</b>
Shtesa	12,980	6,769	1,366	2,544	23,659
Nxjerrje jashte përdorimit	-	-	-	(349)	(349)
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>1,626,510</b>	<b>358,420</b>	<b>2,176</b>	<b>2,544</b>	<b>1,989,650</b>
<b><i>Zhvlerësimi i akumuluar</i></b>					
Më 1 Janar 2011	(1,106,788)	(259,779)	(666)	-	(1,367,233)
Shpenzimi për vitin	(25,337)	(17,802)	(29)	-	(43,168)
Nxjerrje jashte përdorimit	-	-	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2011</b>	<b>(1,132,125)</b>	<b>(277,581)</b>	<b>(695)</b>	<b>-</b>	<b>(1,410,401)</b>
Shpenzimi për vitin	(24,350)	(15,103)	(137)	-	(39,590)
Nxjerrje jashte përdorimit	-	-	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>(1,156,475)</b>	<b>(292,684)</b>	<b>(832)</b>	<b>-</b>	<b>(1,449,991)</b>
<b><i>Vlera kontabël neto</i></b>					
Më 1 Janar 2011	506,742	87,551	144	15,608	610,045
Më 31 Dhjetor 2011	<b>481,405</b>	<b>74,070</b>	<b>115</b>	<b>349</b>	<b>555,939</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>470,035</b>	<b>65,736</b>	<b>1,344</b>	<b>2,544</b>	<b>539,659</b>

**Golden Eagle Sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***8. Aktivet jo materiale**

<i>Kosto</i>	<i>Totali</i>
Më 1 Janar 2011	21,450
Shtesa	-
Pakësime	-
<b>Më 31 Dhjetor 2011</b>	<b>21,450</b>
Shtesa	1,439
Pakësime	-
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>22,889</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>	
Më 1 Janar 2011	(18,123)
Shpenzimi për vitin	(832)
Pakësime	-
<b>Më 31 Dhjetor 2011</b>	<b>(18,955)</b>
Shpenzimi për vitin	(880)
Pakësime	-
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>(19,835)</b>
<i>Vlera kontabël neto</i>	
Më 1 Janar 2011	3,327
Më 31 Dhjetor 2011	2,495
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>3,054</b>

**9. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga:

	<i>31 Dhjetor 2012</i>	<i>31 Dhjetor 2011</i>
Llogari të pagueshme	18,621	14,538
Të pagueshme ndaj/(per) palëve të lidhura:		
Rogner International Hotels and Resorts	14,692	5,812
Rogner GmbH	(6,030)	-
Spa Therme Blumau Betriebs GmbH (Rogner Badblumau)	13,021	-
<b>Totali</b>	<b>40,304</b>	<b>20,350</b>

**Golden Eagle Sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***10. Të pagueshme të tjera**

Të pagueshmet e tjera përbëhen nga:

	<i>31 Dhjetor 2012</i>	<i>31 Dhjetor 2011</i>
Detyrime të llogaritura	42,914	66,836
Kosto personeli të llogaritura	2,840	3,662
TVSH e pagueshme	3,878	5,037
Detyrime të tjera	2,808	2,912
<b>Totali</b>	<b>52,440</b>	<b>78,447</b>

***Detyrimet e llogaritura***

Detyrimet e llogaritura përbëhen nga:

	<i>31 Dhjetor 2012</i>	<i>31 Dhjetor 2011</i>
Të pagueshme ndaj doganes	-	40,712
Leje vjetore të përlllogaritura	14,064	11,700
Tarifë auditimi e pagueshme	687	684
Furnitorë të tjerë	25,778	11,870
Detyrime të ndryshme	2,383	1,870
	<b>42,912</b>	<b>66,836</b>

Të pagueshmet ndaj doganës më 31 Dhjetor 2011 kanë të bëjë me një detyrim të vlerësuar prej Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në shumën 26,054 mijë LEK, reduktuar me 1% të kësaj shume e cila është paguar tashmë nga Shoqëria gjatë 2007. Detyrimi është rivlerësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) më 16 Dhjetor 2008 në shumën 27,565 mijë LEK, shume kjo e përbërë prej detyrimit doganor dhe interesave të llogaritura. Më 20 Shkurt 2009, Zyra e Përmbarimit paraqiti kërkesën për ekzekutimin/pagimin e borxhit doganor nga Shoqëria duke përfshirë detyrimin dhe gjrobat. Më 17 Prill 2009 Shoqëria paraqiti një padi kundër DPD dhe Degës së Doganave të Tiranës, duke kërkuar anulimin e borxhit dhe të gjobave. Gjatë vitit 2009, Shoqëria beri një provizion për të gjithë shumën e detyrimit, sipas vlerësimit të bërë nga DPD më 16 Dhjetor 2008 dhe vlerësoi gjoba të mëtejshme në shumën prej 13,418 mijë LEK të barabarta me shumën e detyrimit doganor. Gjatë 2012, provizioni i akumuluar në shumën prej Lek 40,712 mijë është anuluar bazuar në vendimin nr. 1654 datë 25 Qershor 2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe është përfshirë në të hyra të tjera.

***Kosto personeli të llogaritura***

Kostot e personelit të llogaritura përbëhen nga:

	<i>31 Dhjetor 2012</i>	<i>31 Dhjetor 2011</i>
Paga	416	1,208
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat personale	2,424	2,454
	<b>2,840</b>	<b>3,662</b>



## Golden Eagle Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 11. Kapitali aksionar

Shoqëria ka lëshuar dhe autorizuar një kapital aksionar që përbehet nga 5,650 aksione me vlerë nominale të fiksuar në 1,000 USD për aksion (ose 94,325 LEK për aksion) të përbëre si më poshtë:

	31 Dhjetor 2012 dhe 2011		
	Në %	Në nr. aksionesh	(në LEK '000)
Rogner GmbH	75.81	4,283	404,019
Rogner International Hotels&Resorts GmbH	24.19	1,367	128,917
	100.00	5,650	532,936

Ne 31 Dhjetor 2012 dhe 2011, ekuivalenti ne Lek i kapitalit aksioner te autorizuar eshte perkthyer duke aplikuar kursin historik te kembimit 1 USD = 94.32 Lek.

#### Rezerva ligjore

Në bazë të ligjit të mëparshëm shqiptar për shoqëritë, shoqëritë tregtare kërkohej të transferonin një minimum prej 5% të të ardhurave të tyre vjetore neto në fondin e rezervës ligjore, deri sa kjo rezervë të përbënte një të dhjetën e kapitalit aksioner. Kjo shumë nuk mund të shpërndahej.

Më 14 Prill 2008, në Shqipëri hyri ne fuqi një ligj i ri për shoqëritë tregtare sipas të cilit nuk kërkohej më që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara të njohin ndonjë rezervë ligjore.

#### 12. Të ardhurat

Balanca përbëhet si më poshtë:

	Fundviti 31 Dhjetor 2012	Fundviti 31 Dhjetor 2011
Dhoma	270,916	279,124
Ushqim dhe pije	191,385	216,078
Qera dhe të ardhura të tjera	40,685	43,759
Të ndryshme	23,961	9,736
	<b>526,947</b>	<b>548,697</b>

**Golden Eagle Sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***13. Materialet e konsumuara**

Balanca përbëhet si më poshtë:

	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2012</b>	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2011</b>
Ushqim	35,587	34,211
Pajisje operative	48,079	14,549
Pije	13,995	13,434
Të tjera	3,815	3,545
	<b>101,476</b>	<b>65,739</b>

**14. Shërbime**

Balanca përbëhet si më poshtë:

	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2012</b>	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2011</b>
Tarifa profesionale	28,299	34,183
Tarifa menaxhimi	47,878	56,673
Mirëmbajtje	18,878	17,202
Energji dhe ujë	23,444	22,025
Kosto sigurimi	3,023	2,375
Argëtim	4,678	6,032
Shpenzime të tjera	53,104	33,728
	<b>179,304</b>	<b>172,218</b>

Shpenzime të tjera përbëhet nga:

	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2012</b>	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2011</b>
Auditim dhe konsulencë	15,738	6,754
Të tjera	8,532	6,330
Shpenzime pastrimi	7,643	6,351
Udhëtime dhe rezervime	5,367	3,096
Shërbime interneti	4,404	2,311
Shpenzime telefoni	4,402	4,905
Shërbime sigurie	2,530	2,520
Trajnime	2,003	17
Shpenzime transporti	978	26
Tarifa anëtarësimi	774	838
Transport Personeli	733	580
	<b>53,104</b>	<b>33,728</b>

**Golden Eagle Sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***15. Kosto e personelit**

Kosto e personelit përbëhet si më poshtë:

	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2012</b>	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2011</b>
Paga	97,202	81,196
Kontributi për sigurimet shoqërore	10,846	9,712
	<b>108,048</b>	<b>90,908</b>

**16. Shpenzime të tjera**

Balanca përbëhet si më poshtë:

	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2012</b>	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2011</b>
Shpenzime autofaturimi	98,858	102,648
Të tjera	9,121	12,283
Shpenzime marketingu	6,163	5,673
Taksa lokale	5,964	5,407
Komisone te Agjensive te Udhetimit	5,272	4,074
Fondi për humbje nga zhvlerësimin –të arkëtueshmet	4,845	1,982
Qera toke	2,099	2,118
Gjoha dhe ndëshkime	276	790
	<b>132,598</b>	<b>134,975</b>

Shpenzimet e autofaturimit janë një mekanizëm i aplikuar nga Shoqëria për qëllime të raportimit të TVSH-së lidhur me shërbimet e ofruara prej entiteteve jo-rezidente (dmth të paregjistruara për TVSH në Shqipëri). Të ardhura të tjera në shumën prej Lek 98,858 mijë (2011: Lek 102,648 mijë) janë njohur si kundërparti e këtij shpenzimi për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011.

**17. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përbëhen si më poshtë:

	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2012</b>	<b>Fundviti 31 Dhjetor 2011</b>
Interesa dhe komisione bankare	(6,161)	(7,163)
<b>Totali i shpenzimeve financiare</b>	<b>(6,161)</b>	<b>(7,163)</b>
Të ardhura nga interesat	7,010	4,790
Fitime/(humbje) neto nga kurset e këmbimit	2,748	(632)
<b>Totali i të ardhurave financiare</b>	<b>9,758</b>	<b>4,158</b>
<b>Kosto financiare neto</b>	<b>3,597</b>	<b>(3,005)</b>

## Golden Eagle Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 18. Shpenzimi për tatim fitimit

Pasqyra më poshtë paraqet një rikoncilim të fitimit per qellime ligjore sipas kërkesave të ligjit tatimor:

	Fundviti 31 Dhjetor 2012	Fundviti 31 Dhjetor 2011
Fitimi para tatimit	115,047	140,500
<i>Rregullimet për rikoncilim të fitimit të tatueshëm</i>		
Të ardhura të pa tatueshme	(40,713)	
Shpenzimet e pazbritshme	9,908	15,910
Fitimi sipas legjislacionit Shqiptar	84,242	156,410
<b>Norma e tatimit (norma: 10%)</b>	<b>8,424</b>	<b>15,641</b>

E ardhura e pa tatueshme lidhet me rrimarrjen e provizionit të krijuar gjatë viteve 2009 dhe 2007 dhe trajtuar si shpenzim i pazbritshëm në vitet kur është njohur (shih gjithashtu shënimin 10).

#### 19. Palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie palësh të lidhura me shoqërinë mëmë dhe me shoqëri të tjera që janë nën një kontroll të përbashkët me Shoqërinë dhe filiale të këtyre shoqërive, drejtorët e tyre, drejtuesit ekzekutivë dhe aksionerë të tjerë. Palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive të Shoqërisë me to janë sa mëposhte:

- Rogner International Hotels and Resorts GmbH – aksioner
- Rogner GmbH – aksioner
- Spa Therme Blumau Betriebs GmbH (Rogner Badblumau)-pjesë e grupit

Gjatë vitit 2012 dhe 2011, Shoqëria ka marrë pjesë në një sërë transaksionesh me palët e lidhura. Një përmbledhje e balancave të palëve të lidhura jepet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
<i>Të pagueshme</i>		
Rogner International Hotels and Resorts	14,692	5,812
Spa Therme Blumau Betriebs GmbH (Rogner Badblumau)	13,021	-
Rogner GmbH	(6,030)	-
<b>Totali</b>	<b>21,683</b>	<b>5,812</b>

Shuma që i detyrohet Rogner International Hotels and Resorts më 31 Dhjetor 2012 dhe 31 Dhjetor 2011 i referohet tarifës së papaguar të menaxhimit. Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura të përfshira në shpenzimet operative jepet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
<i>Shpenzime</i>		
Rogner International Hotels and Resorts	108,473	91,209
Spa Therme Blumau Betriebs GmbH (Rogner Badblumau)	14,889	-
Rogner GmbH	14,191	11,320
Kosto personeli e Drejtuesve	14,703	15,425
<b>Totali</b>	<b>152,256</b>	<b>117,954</b>

Shpenzimet e Rogner International Hotels and Resorts kanë të bëjnë me blerjen e mallrave dhe kryesisht me shërbime profesionale të menaxhimit administrativ që i janë ofruar Shoqërisë përgjatë vitit. Shpenzimet e Rogner GmbH përfshijnë shërbime konsulence të profesionale që i janë ofruar Shoqërisë.

## Golden Eagle Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 20. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

##### Angazhime të qerasë

Shoqëria i paguan qera vjetore Bashkise së Tiranës për përdorimin e tokës mbi të cilën hoteli është pozicionuar për një periudhë kohore maksimale prej 99 vjet e cila përfundon më 2093. Qeraja vjetore është e fiksuar në 0.94 USD për metër katror ose 20 mijë USD në vit. Qeraja është e pagueshme 6 muaj në avancë përmes dy kësteve në datat 1 Janar dhe 1 Qershor të çdo viti. Angazhimet e qerasë paraqiten si më poshtë:

	2012	2011
Brenda një viti	2,130	2,118
Midis një dhe pesë viteve	8,520	8,472
Përtej pesë viteve	161,880	160,968
	<b>172,530</b>	<b>171,558</b>

##### Çështje ligjore

Shoqëria më datë 31 Dhjetor 2012 është subjekt/palë e tretë në paditë, pretendimet dhe çështjet gjyqësore të mëposhtme:

###### 1. Rikthimi i Tokës:

- Objekti i padisë është “Anullimi pjesor i vendimit Nr. 1111 datë 18.09.1996 të Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”. Përmes kësaj padie pronarët e mëparshëm të tokës kërkojnë rikthim në natyrë të 340 metrave katrorë me arsyetimin se parcela në fjalë nuk është pjese e objektit të Kontratës së Qerasë të Shoqërisë me Republikën e Shqipërisë. Çështja u fitua nga Golden Eagle në shkallën e parë dhe të dytë, si edhe Gjykatën e Lartë.
- Objekt i padisë është “Kërkesë për rikthim në natyrë të 1,188 metra katrorë bazuar në vendimin e vitit 1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si edhe detyrimi për pagesën e qerasë”. Çështja u fitua nga Golden Eagle në shkallën e parë më 2 Qershor 2009 dhe u apelua më 16 Qershor 2009. Gjykata e Apelit e vendosi ta kthejë çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit të Tiranës.

Shoqëria, Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Turizmit janë palë të treta në këtë padi, ku paditësi është ish pronari/pasuesi ligjor i ish pronarit dhe i paditur është Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Menaxhimi bazuar në konsulencën ligjore, beson se nuk ka ndonjë kërcënim potencial ekonomik. Bashkia i ka garantuar Shoqërisë një përdorim të pacënueshëm të tokës, objekt i pretendimeve, në zbatim të Kontratës së Qerasë së Tokës.

###### 2. Kodi i punës

Shoqëria është e përfshirë si palë mbrojtëse në një padi me një nga punonjësit e saj të mëparshëm i cili kërkon kompensim për largim të pajustificuar nga puna dhe dëmshpërblim të dëmeve. Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi pjesërisht padinë e ish punonjësit duke i dhënë të drejtë dhe ky vendim është apeluar nga paditësi.

Drejtimi beson se kostot e zgjidhjes së kësaj çështjeje nuk do të kenë ndonjë efekt material në rezultatin financiar të Shoqërisë, rezultatin operativ apo flukset e parasë, bazuar në faktin se ky punonjës është larguar nga detyra në përputhje me procedurat dhe periudhën e njoftimit sikurse përshkruhet në Kodin e punës dhe Kontratën e Punësimit.

#### 21. Ngjarje pas datës së raportimit

Pas datës së raportimit nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.